FLETORJA ZYRTARE
E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 107	2003	Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9157 datë 4.12.2003	Për përgjimin e telekomunikimeve……...	4593
Vendim i Kuvendit nr.95, datë 29.12.2003	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërim dhe shkarkim ministri……	4599
Vendim i Kuvendit nr.96, datë 29.12.2003	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Namik Dokle në detyrën e Zëvendëskryeministrit	4599
Vendim i Kuvendit nr.97, datë 29.12.2003	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkim dhe emërim ministri……	4600
Vendim i Kuvendit nr.98, datë 29.12.2003	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkim dhe emërim ministri……...	4600
Vendim i Kuvendit nr.99, datë 29.12.2003	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Anastas Angjeli në detyrën e Ministrit të Ekonomisë	4601
Vendim i Kuvendit nr.100, datë 29.12.2003	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e zotit Spiro Peçi nga detyra e Ministrit të Drejtësisë	4601
Vendim i Kuvendit nr.101, datë 29.12.2003	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Fatmir Xhafa në detyrën e Ministrit të Drejtësisë	4602

Vendim i Kuvendit nr.102, datë 29.12.2003	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e zotit Besnik Dervishi nga detyra e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit……..	4602
Vendim i Kuvendit nr.103, datë 29.12.2003	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Bashkim Fino në detyrën e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit……	4603
Vendim i Kuvendit nr.104, datë 29.12.2003	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e zotit Mustafa Xhani nga detyra e Ministrit të Shëndetësisë.	4603
Vendim i Kuvendit nr.105, datë 29.12.2003	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Leonard Solis në detyrën e Ministrit të Shëndetësisë	4604
Vendim i Kuvendit nr.106, datë 29.12.2003	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e zonjës Valentina Leskaj nga detyra e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale……..	4604
Vendim i Kuvendit nr.107, datë 29.12.2003	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Engjëll Bejtaj në detyrën e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale	4605
Vendim i Kuvendit nr.108, datë 29.12.2003	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e zonjës Arta Dade nga detyra e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve……..	4605
Vendim i Kuvendit nr.109, datë 29.12.2003	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkim dhe emërim ministri……..	4606
Vendim i Kuvendit nr.110, datë 29.12.2003	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e zotit Lufter Xhuveli nga detyra e Ministrit të Mjedisit	4606
Vendim i Kuvendit nr.111, datë 29.12.2003	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Et'hem Ruka në detyrën e Ministrit të Mjedisit	4607
Vendim i Kuvendit nr.112, datë 29.12.2003	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Marko Bello në detyrën e Ministrit të Shtetit për Koordinimin	4607
Vendim i Kuvendit nr.113, datë 29.12.2003	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e zotit Igli Toska në detyrën e Ministrit të Rendit Publik.	4608
Vendim i KM nr.832, datë 11.12.2003	Për miratimin e rregullores së administrimit të qytetit muze të Gjirokastrës…….……	4608
Vendim i KM nr.840, datë 20.12.2003	Për miratimin e listës së ofertuesve dhe shpalljen e fituesit, në tenderin e hapur ndërkombëtar, për privatizimin e Bankës së Kursimeve sh.a	4612
Vendim i KM nr.848, datë 19.12.2003	Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë "Uzina Mekanike e Naftës" sh.p.k., Kuçovë dhe kriteret bazë për përzgjedhjen e investitorit e për vlerësimin e ofertave	4614
Vendim i KM nr.849, datë 19.12.2003	Për funksionimin e Fototekës Kombëtare "Marubi" dhe për kalimin e përgjegjësisë së administrimit nga Bashkia e Shkodrës Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve…….	4616

Vendim i KM nr.857, datë 19.12.2003	Për miratimin e rregullores së funksionimit të Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar të Butrintit	4617
Udhëzim i MBU dhe ME nr.1, datë 10.12.2003	Për administrimin e pasurisë shtetërore në përdorim të Organizatave të Menaxhimit të Peshkimit (OMP)…….....	4624
Urdhër i MBU nr.17/5, datë 16.12.2003	Për miratimin e statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP Butrint)……	4625

L I G J
Nr.9157, datë 4.12.2003

PËR PËRGJIMIN E TELEKOMUNIKIMEVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton procedurat që duhet të ndiqen për përgjimin e telekomunikimeve nga institucione shtetërore informative të krijuara me ligj për realizimin e detyrave të tyre, si dhe procedurat që duhet të ndiqen nga personat e ngarkuar për përgjim.

Neni 2
Qëllimi

Ky ligj synon të rrisë efektivitetin e punës së institucioneve shtetërore informative për zbulimin e veprimtarisë antikushtetuese, kriminale dhe keqbërëse, si dhe të parandalojë pasojat që mund të vijnë nga kjo veprimtari.

Neni 3
Përkufizime

Në zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Bërthama komanduese elektronike" është pajisja teknike në administrim të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, e cila lejon ose ndalon përgjimin e një pajisjeje telekomunikacioni.
2. "Objekt përgjimi" janë sinjalet, shkrimet, fotografitë, të dhënat audiovizuale ose lloj tjetër informacioni, për të marrë ose transmetuar nëpërmjet pajisjeve të telekomunikacionit.
3. "Operator publik i telekomunikacionit" është subjekti, i cili ndërton ose shfrytëzon një rrjet telekomunikacioni ose ofron shërbime të tilla.
4. "Pajisje fundore" është çdo pajisje në përdorim nga subjekti i përgjimit që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me një pikë fundore të rrjetit të telekomunikacioneve për të realizuar telekomunikimin.
5. "Pajisje telekomunikacioni" është çdo mjet teknik (linjë transmetimi, pajisje komutimi dhe çdo pajisje tjetër e nevojshme për të siguruar funksionimin e rrjetit të telekomunikimeve) që shërben për realizimin e telekomunikacioneve.
6. "Përgjim" është ndërhyrja e fshehtë për të kapur, dëgjuar e regjistruar përmbajtjen e komunikimit dhe të dhëna që lidhen me të ndërmjet pikës së nisjes e pikës së mbërritjes.
7. "Situatë emergjente" është situata kur, nga respektimi i kërkesave të këtij ligji për paraqitjen e miratimin e kërkesës me shkrim, dëmtohet rezultati i përgjimit, duke sjellë pasoja të rënda për sigurinë kombëtare.
8. "Subjekt përgjimi" janë personat e dyshuar si autorë krimesh të rënda.
9. "Telekomunikim" është hyrja në lidhje me dikë, nëpërmjet pajisjeve të telekomunikacionit.

Neni 4
Parimet e përgjimit

Parimet bazë për përgjimin e telekomunikimeve janë respektimi i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, nevojshmëria dhe proporcionaliteti, sekreti dhe objektiviteti në kryerjen e tij.

Neni 5
Përdorshmëria e rezultateve të përgjimit

Rezultatet e përgjimit, të marra në bazë të këtij ligji, nuk kanë vlerën e provës në një proces penal, me përjashtim të atyre të marra sipas Kodit të Procedurës Penale.

KREU II
PROCEDURAT PËR KRYERJEN E PËRGJIMIT

Neni 6
Organet që mund të kërkojnë kryerjen e përgjimit

1. Shërbimi Informativ Shtetëror, shërbimet informative/policore të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe çdo shërbim tjetër informativ/policor, i krijuar me ligj, kanë të drejtë të kërkojnë përgjimin, për të siguruar të dhënat e domosdoshme për realizimin e detyrave të tyre ligjore.

2. Asnjë prej institucioneve publike të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni nuk ka të drejtë të parashtrojë një kërkesë për përgjim për çështje ose veprimtari që nuk janë parashikuar me ligj në objektin e punës e të veprimtarisë së tyre informativo-gjurmuese.

Neni 7
Kërkesa për përgjim

1. Kërkesa për përgjim, e paraqitur nga subjektet e parashikuara në nenin 6 të këtij ligji, hartohet në dy kopje, një kopje e së cilës depozitohet pranë Prokurorit të Përgjithshëm dhe një e mban vetë institucioni.

2. Kërkesa përmban:

a) institucionin kërkues, emrat dhe funksionet e punonjësve që ndjekin procesin informativo-gjurmues;

b) gjeneralitetet dhe adresën e subjektit në proces informativo-gjurmues ose në ndjekje, si dhe adresën e mjedisit/mjediseve me të cilat lidhet kërkesa për përgjim;

c) përshkrimin e telekomunikimeve që do të përgjohen dhe të dhënat për operatorin e telekomunikacionit që i ofron shërbim subjektit që do të përgjohet;

ç) arsyet e përgjimit, si dhe bazën dokumentare ose materialin informativ ku mbështetet kërkesa për përgjim;

d) argumentet që vërtetojnë se përgjimi është i domosdoshëm në situatën e krijuar dhe se të dhënat që kërkohen nuk mund të sigurohen me mjete të tjera;

dh) afatin kohor brenda të cilit kërkohet të bëhet përgjimi.

Neni 8
Dhënia e të drejtës për përgjim

Prokurori i Përgjithshëm ose, në mungesë të tij, prokurori i autorizuar prej tij, pas shqyrtimit të kërkesës me shkrim të Drejtorit të SHISH-it, Ministrit të Rendit Publik, Ministrit të Mbrojtjes ose Ministrit të Drejtësisë, miraton ose refuzon kërkesën për përgjimin e telekomunikimeve nëpërmjet pajisjeve të telekomunikacionit.

Neni 9
Vendimi për përgjim

1. Prokurori i Përgjithshëm ose prokurori i autorizuar prej tij, në mungesë të Prokurorit të Përgjithshëm, merr vendim me shkrim për kërkesën për përgjim, i cili hartohet në tri kopje. Një kopje

e vendimit që miraton kërkesën, mbahet në bërthamën komanduese elektronike të Prokurorisë, një e mban Sektori i Përgjimeve në SHISH dhe një kopje institucioni që ka bërë kërkesën.

2.Vendimet e përgjimit janë të vlefshme për komunikime nëpërmjet pajisjeve të telekomunikacionit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj, kur ka marrëveshje dypalëshe.

Neni 10

Përmbajtja e vendimit për përgjim

Vendimi për përgjim përmban:

a) detyrimin e sektorit përkatës në SHISH;

b) institucionin që ka bërë kërkesën;

c) gjeneralitetet dhe adresën e subjektit në proces përgjimi ose në ndjekje dhe mjedisin/mjediset e identifikuara, për të cilat do të kryhet përgjimi;

ç) numrin e protokollit;

d) afatin ose afatet e përgjimit, ku përcaktohet data dhe ora e fillimit dhe e mbarimit;

dh) operatorin e telekomunikacionit që siguron komunikimin;

pajisjet fundore që përdor subjekti i përgjimit për realizimin e telekomunikimit.

Neni 11

Ndryshimi i pajisjes fundore

Pas marrjes së vendimit për përgjim, kur vihet re se pajisjet fundore të subjektit që përgjohet janë shtuar ose ndryshuar, nuk përsëritet kërkesa për përgjim. Në këtë rast institucioni shtetëror informativ që ka kërkuar përgjimin është i detyruar të njoftojë me shkrim për pajisjen e re fundore Prokurorin e Përgjithshëm dhe Sektorin e Përgjimeve në SHISH. Afatet e përgjimit në këtë rast mbeten të pandryshuara.

Neni 12

Sektori i Përgjimeve

1. Sektori i Përgjimeve në SHISH realizon vetëm proceset teknike të përgjimit, nëpërmjet pajisjeve të telekomunikacionit për llogari të institucioneve shtetërore informative, pasi është marrë vendimi për përgjim sipas këtij ligji.

2. Punonjësit e Sektorit të Përgjimeve në SHISH fillojnë marrëdhëniet e punës pasi njoftohet më parë Prokurori i Përgjithshëm.

3. Realizimi i përgjimit nga Sektori i Përgjimeve në SHISH bëhet nëpërmjet sistemeve të instaluara për këtë qëllim. Sistemi i përgjimit kurdoherë duhet të jetë i përbërë nga dy pjesë, të cilat nuk mund të funksionojnë në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra.

Neni 13

Bërthama komanduese elektronike

Bërthama komanduese elektronike është pajisje teknike në administrim pranë Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, e cila lejon ose ndalon përgjimin e një pajisjeje fundore. Punonjësi i bërthamës komanduese elektronike, pas vendimit me shkrim për miratimin e kërkesës për përgjim, mundëson teknikisht procesin e përgjimit nga Sektori i Përgjimit në SHISH.

Neni 14

Kohëzgjatja e vendimit të përgjimit

1. Të gjitha vendimet e përgjimit janë të vlefshme për një periudhë deri në tre muaj. Për çdo zgjatje të këtij afati, institucioni shtetëror informativ i paraqet Prokurorit të Përgjithshëm një kërkesë së bashku me materialin e deriatëhershëm të zbardhur.

2. Çdo zgjatje afati nuk mund të jetë më tepër se tre muaj.

3. Nëse ndodh një ndryshim, që çon në përfundimin se përgjimi nuk është më i nevojshëm ose praktik për t'u zbatuar, atëherë, me kërkesë me shkrim të institucionit shtetëror informativ ose me nismën e Prokurorit të Përgjithshëm, vendimi revokohet.

Neni 15
Njohja me rezultatet e përgjimit

1. Prokurori i Përgjithshëm ka të drejtë të njihet në çdo kohë, nga drejtuesi i institucionit që ka kërkuar përgjimin, me rezultatet e përgjimit si gjatë afatit të përgjimit, ashtu edhe pas përfundimit të tij.

2. Me rezultatet e përgjimit njihet vetëm drejtuesi i institucionit shtetëror informativ që ka kërkuar përgjimin.

Neni 16
Kufizimet në përgjim

1. Personave të ngarkuar me funksionin apo detyra të caktuara në ose për procesin e përgjimit në tërësi apo në veçanti u ndalohet:

a) të përhapin ose të përdorin jashtë kërkesave të këtij ligji apo të ligjeve në fuqi të dhënat e grumbulluara;

b) të përgjojnë pa autorizim ose jashtë procedurave të ngarkuara nga Prokurori i Përgjithshëm.

2. Procesi i përgjimit, në tërësi ose në veçanti, përbën sekret shtetëror, shkelja e të cilit dënohet sipas legjislacionit penal në fuqi.

Neni 17
Situatat emergjente

1. Për situata emergjente, Prokurori i Përgjithshëm ose prokurori i autorizuar prej tij, me kërkesë verbale të drejtuesit të institucionit shtetëror informativ, sipas nenit 6 të këtij ligji, urdhëron me shkrim realizimin teknik të procesit të përgjimit. Urdhri regjistrohet menjëherë në evidencat e bërthamës komanduese elektronike pranë Prokurorit të Përgjithshëm dhe te specialistët e Sektorit të Përgjimeve në SHISH. Me regjistrimin e urdhrit, specialistët e Sektorit të Përgjimeve realizojnë procesin e përgjimit.

2. Brenda 24 orëve nga fillimi i përgjimit, institucioni shtetëror informativ që ka bërë kërkesën, i paraqet Prokurorit të Përgjithshëm kërkesën e rregullt me shkrim, e cila përmban arsyet e veprimeve emergjente së bashku me komunikimin e përgjuar të zbardhur. Mbi këtë bazë merret vendimi përkatës për vazhdimin ose ndërprerjen e përgjimit.

3. Mosparaqitja e kërkesës me shkrim brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, sjell ndërprerjen e menjëhershme të përgjimit.

Neni 18
Revokimi i vendimit të përgjimit

1. Prokurori i Përgjithshëm, kur gjykon se përgjimi nuk është më i vlefshëm sipas ligjit, revokon në çdo kohë vendimin për përgjim para datës së përfundimit të përgjimit.

2. Vendimi i revokimit u adresohet bërthamës komanduese elektronike, kërkuesit e zbatuesit teknik të përgjimit.

KREU III
KËRKESA TË VEÇANTA PËR PËRGJIM

Neni 19
Përgjimi me kërkesë të shërbimeve të huaja

Me kërkesë të shërbimeve të huaja sekrete dhe me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm,

Sektori i Përgjimeve në SHISH mund të realizojë përgjimin, sipas këtij ligji, për llogari të shërbimit sekret të huaj.

Neni 20
Ruajtja dhe kopjimi i materialit të përgjimit

1. Materiali i përgjimit ruhet në rast se, sipas vlerësimit të Prokurorit të Përgjithshëm, ka premisa të bëhet i rëndësishëm për ruajtjen e jetës, sigurisë kombëtare, rendit publik ose parandalimin e krimeve të rënda.

2. Drejtuesi i institucionit shtetëror informativ i bën kërkesën me shkrim Prokurorit të Përgjithshëm për ruajtjen e materialit të përgjimit. Prokurori i Përgjithshëm duhet t'i përgjigjet me shkrim drejtuesit të institucionit brenda 72 orëve nga marrja e kërkesës.

3. Në rast se kërkesa refuzohet, materiali i përgjimit asgjësohet menjëherë, sipas mënyrës së përcaktuar nga Prokurori i Përgjithshëm në bashkëpunim me Drejtorin e SHISH-it.

4. Në rast se kërkohet kopjimi i materialit të përgjimit, kërkesa me shkrim e drejtuesit të shërbimit shtetëror informativ i drejtohet për miratim Prokurorit të Përgjithshëm së bashku me arsyet e kopjimit.

KREU IV
OPERATORËT E TELEKOMUNIKACIONEVE

Neni 21
Aftësitë përgjuese të rrjeteve të telekomunikacioneve

1. Operatorët e telekomunikacioneve realizojnë me shpenzimet e tyre infrastrukturën e nevojshme në rrjetin e tyre të telekomunikacioneve, për të siguruar aftësinë përgjuese ndaj përdoruesve që shfrytëzojnë shërbimet e telekomunikacioneve të ofruara prej tyre.

2. Infrastruktura që realizohet nga operatorët e telekomunikacioneve për të siguruar aftësinë përgjuese duhet të jetë në përputhje teknologjike me pajisjet e bërthamës komanduese elektronike dhe Sektorit të Përgjimeve në SHISH.

3. Operatorët e telekomunikacioneve janë të detyruar të ofrojnë pa pagesë çdo shërbim në funksion të procesit të përgjimit.

4. Kur operatorët e telekomunikacioneve bëjnë përmirësimin e teknologjive, detyrohen të mbulojnë me shpenzimet e veta vazhdueshmërinë e funksionimit të procesit të përgjimit.

Neni 22
Asistenca e operatorëve të telekomunikacioneve

1. Kur përgjimi nuk mund të realizohet nëpërmjet sistemit të përgjimit, Drejtori i SHISH-it kërkon ndihmën e çdo operatori të telekomunikacionit në Republikën e Shqipërisë dhe operatorët janë të detyruar të ndërmarrin hapat e nevojshëm.

2. Në këto raste operatorit i jepet kopje e vendimit të Prokurorit të Përgjithshëm ose të autorizuarit prej tij, me përmbajtje të shkurtuar dhe pa të dhëna që mund të dëmtojnë procesin informativo-gjurmues. Kjo kopje duhet të përmbajë afatin kohor për gjetjen nga operatori të numrave, adresave ose faktorëve të tjerë që duhen identifikuar për përgjimin. Kur është e nevojshme, kopja e vendimit shoqërohet edhe me një dokument shtesë, ku përcaktohen hollësitë e tjera teknike për pajisjet e telekomunikacionit.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 23
Përgjimet me vendim gjykate

1. Sektori i Përgjimeve në SHISH realizon edhe proceset teknike të përgjimit të

komunikimeve nëpërmjet pajisjeve të telekomunikacionit, në bazë të neneve 221 deri 226 të Kodit të Procedurës Penale.

2. Në këtë rast përgjimet realizohen nga prokurori ose oficeri i Policisë Gjyqësore dhe specialisti i përgjimeve luan rolin e asistentit teknik pa u vënë në dijeni të rezultatit të përgjimit.

3. Prokurori i Përgjithshëm ose prokurori i autorizuar prej tij me akt zyrtar bashkëshoqëron dhe komunikon vendimin e gjykatës, i cili regjistrohet në Sektorin e Përgjimeve.

Neni 24
Nxjerrja e akteve nënligjore

Prokurori i Përgjithshëm në bashkëpunim me Drejtorin e Shërbimit Informativ Shtetëror përcaktojnë:

a) mënyrën e detajuar të realizimit të proceseve të përgjimit, sipas kërkesave të neneve 6, 10, 13, 14 dhe 15 të këtij ligji;

b) rregullat për ruajtjen e sekretit dhe të dokumentacionit të dalë nga procesi i përgjimit, sipas neneve 16 dhe 20 të këtij ligji;

c) mënyrën e ruajtjes dhe asgjësimit të materialit të përgjimit, sipas nenit 20 të këtij ligji.

Neni 25
Shfuqizime

Çdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohet.

Neni 26
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4053, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

V E N D I M
Nr.95, datë 29.12.2003

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIM DHE SHKARKIM MINISTRI

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.4049, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.4049, datë 28.12.2003:

1.Për shkarkimin e zonjës Ermelinda Meksi nga detyra e Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Shtetit për Integrimin Europian.

2. Për emërimin e zonjës Ermelinda Meksi Ministër të Integrimit Europian.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.96, datë 29.12.2003

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E ZOTIT NAMIK DOKLE NË DETYRËN E ZËVENDËSKRYEMINISTRIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.4050, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.4050, datë 28.12.2003 për emërimin e zotit Namik Dokle në detyrën e Zëvendëskryeministrit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.97, datë 29.12.2003

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIM DHE EMËRIM MINISTRI

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.4051, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.4051, datë 28.12.2003:

1. Për shkarkimin e zotit Kastriot Islami nga detyra e Ministrit të Financave.

2. Për emërimin e zotit Kastriot Islami në detyrën e Ministrit të Punëve të Jashtme.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.98, datë 29.12.2003

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIM DHE EMËRIM MINISTRI

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.4052, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.4052, datë 28.12.2003:
1. Për shkarkimin e zotit Arben Malaj nga detyra e Ministrit të Ekonomisë.
2. Për emërimin e zotit Arben Malaj në detyrën e Ministrit të Financave.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.99, datë 29.12.2003

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E ZOTIT ANASTAS ANGJELI NË DETYRËN E MINISTRIT TË EKONOMISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.4055, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.4055, datë 28.12.2003 për emërimin e zotit Anastas Angjeli në detyrën e Ministrit të Ekonomisë.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.100, datë 29.12.2003

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIMIN E ZOTIT SPIRO PEÇI NGA DETYRA E MINISTRIT TË DREJTËSISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.4056, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.4056, datë 28.12.2003 për shkarkimin e zotit Spiro Peçi nga detyra e Ministrit të Drejtësisë.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.101, datë 29.12.2003

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E ZOTIT FATMIR XHAFA NË DETYRËN E MINISTRIT TË DREJTËSISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.4057, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.4057, datë 28.12.2003 për emërimin e zotit Fatmir Xhafa në detyrën e Ministrit të Drejtësisë.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.102, datë 29.12.2003

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIMIN E ZOTIT BESNIK DERVISHI NGA DETYRA E MINISTRIT TË RREGULLIMIT TË TERRITORIT DHE TURIZMIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.4058, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.4058, datë 28.12.2003 për shkarkimin e zotit Besnik Dervishi nga detyra e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.103, datë 29.12.2003

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E ZOTIT BASHKIM FINO NË DETYRËN E MINISTRIT TË RREGULLIMIT TË TERRITORIT DHE TURIZMIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.4059, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.4059, datë 28.12.2003 për emërimin e zotit Bashkim Fino në detyrën e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.104, datë 29.12.2003

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIMIN E ZOTIT MUSTAFA XHANI NGA DETYRA E MINISTRIT TË SHËNDETËSISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.4060, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.4060, datë 28.12.2003 për shkarkimin e zotit Mustafa Xhani nga detyra e Ministrit të Shëndetësisë.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.105, datë 29.12.2003

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E ZOTIT LEONARD SOLIS NË DETYRËN E MINISTRIT TË SHËNDETËSISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.4061, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.4061, datë 28.12.2003 për emërimin e zotit Leonard Solis në detyrën e Ministrit të Shëndetësisë.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.106, datë 29.12.2003

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIMIN E ZONJËS VALENTINA LESKAJ NGA DETYRA E MINISTRIT TË PUNËS DHE

ÇËSHTJEVE SOCIALE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.4062, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.4062, datë 28.12.2003 për shkarkimin e zonjës Valentina Leskaj nga detyra e Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.107, datë 29.12.2003

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E ZOTIT ENGJËLL BEJTAJ NË DETYRËN E MINISTRIT TË PUNËS DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.4063, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.4063, datë 28.12.2003 për emërimin e zotit Engjëll Bejtaj në detyrën e Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.108, datë 29.12.2003

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIMIN E ZONJËS ARTA DADE NGA DETYRA E MINISTRIT TË KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.4064, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.4064, datë 28.12.2003 për shkarkimin e zonjës Arta Dade nga detyra e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.109, datë 29.12.2003

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIM DHE EMËRIM MINISTRI

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.4065, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.4065, datë 28.12.2003:
1. Për shkarkimin e zotit Blendi Klosi nga detyra e Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit.
2. Për emërimin e zotit Blendi Klosi në detyrën e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.110, datë 29.12.2003

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIMIN E ZOTIT LUFTER XHUVELI NGA DETYRA E MINISTRIT TË MJEDISIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.4066, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.4066, datë 28.12.2003 për shkarkimin e zotit Lufter Xhuveli nga detyra e Ministrit të Mjedisit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.111, datë 29.12.2003

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E ZOTIT ET'HEM RUKA NË DETYRËN E MINISTRIT TË MJEDISIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.4067, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.4067, datë 28.12.2003 për emërimin e zotit Et'hem Ruka në detyrën e Ministrit të Mjedisit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.112, datë 29.12.2003

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E ZOTIT MARKO BELLO NË DETYRËN E MINISTRIT TË SHTETIT PËR KOORDINIMIN

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.4070, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.4070, datë 28.12.2003 për emërimin e zotit Marko Bello në detyrën e Ministrit të Shtetit për Koordinimin.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.113, datë 29.12.2003

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIMIN E ZOTIT IGLI TOSKA NË DETYRËN E MINISTRIT TË RENDIT PUBLIK

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.4071, datë 28.12.2003 të Presidentit të Republikës,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.4071, datë 28.12.2003 për emërimin e zotit Igli Toska në detyrën e Ministrit të Rendit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr. 832, datë 11.12. 2003

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ADMINISTRIMIT TË QYTETIT-MUZE TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 nenit 29 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I :

Miratimin e "Rregullores së administrimit të qytetit-muze të Gjirokastrës", e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

RREGULLLORE
E ADMINISTRIMIT TË QYTETIT-MUZE TË GJIROKASTRËS

Neni 1
Qëllimi dhe objektivat

1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave për administrimin, mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin e qytetit-muze të Gjirokastrës, shpallur me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.172, datë 2.6.1961.

2. Objektivat kryesore të kësaj rregulloreje janë:

a) administrimi i qytetit-muze të Gjirokastrës sipas hartës, pjesë integrale e rregullores;

b) mbrojtja dhe restaurimi i vlerave historiko-kulturore të qytetit-muze të Gjirokastrës;

c) mënyrat e bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore të qytetit të Gjirokastrës për miradministrimin, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të qytetit-muze.

Neni 2
Struktura e qytetit-muze të Gjirokastrës

Qyteti-muze i Gjirokastrës përbëhet nga:

1. Qendra historike, e cila përfshin:

a) zonën muze, e cila përfshin: kështjellën, pazarin e qytetit, lagjet: Pazar i Vjetër, Pllakë, Hazmurat, Teqe; pjesë të lagjeve Varosh, Mesitë, Palorto dhe Dunavat i Parë, si dhe ansamble të lagjeve: Dunavat i Dytë, Manalat dhe Cfakë;

b) zonën e mbrojtur, e cila rrethon zonën muze, sipas hartës;

c) zonën e lirë ose zona tampon, e cila rrethon qendrën historike, së bashku me zonën e mbrojtur, sipas hartës.

Neni 3
Zona muze

Zona muze është pjesa më me vlerë e qendrës historike. Ajo mbrohet në tërësi si kompleks monumental urbanistik, arkitektonik dhe ambiental. Në këtë zonë mund të lejohen vetëm rikonstruksione të ndërtimeve ekzistuese, të cilat konsiderohen të domosdoshme për jetën e qendrës historike. Projektet e restaurimit hartohen nga IMK-ja ose subjekte të licencuara për këtë qëllim nga ana e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të cilat miratohen nga ana e Këshillit Kombëtar të Restaurimit. Rijetëzimi dhe shfrytëzimi i momumenteve të kulturës në zonën muze, për nevoja apo qëllime administrative dhe social-kulturore, mund të lejohen, por pa cenuar vlerat për të cilat ato janë vënë në mbrojtje. Në çdo rast, leja e shfrytëzimit për qëllimet e mësipërme merret nga IMK-ja.

Neni 4
Zona e mbrojtur

Zona e mbrojtur me vlerat e saj urbanistike, arkitektonike dhe ambientale luan një rol të rëndësisë së veçantë në tërësinë e qendrës historike. Në zonën e mbrojtur nuk lejohen ndërtime të reja, përveç rikonstruksioneve dhe ndërhyrjeve restauruese, të cilat propozohen nga IMK-ja ose Drejtoria Rajonale e Monumenteve të Kulturës Gjirokastër dhe miratohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve. Në çdo rast, këto ndërhyrje mbikëqyren nga institucionet përkatëse shtetërore, në përputhje dhe duke ruajtur harmoninë me monumentet e kulturës.

Neni 5
Zona e lirë

Zona e lirë apo zona tampon është pjesë e qytetit-muze, jashtë zonës së mbrojtur të qendrës historike, por përreth saj. Në këtë zonë lejohen adaptime, ndërtime shtesë, si dhe ndërtime të reja. Në të gjitha rastet duhet të respektohen veçantitë e qytetit-muze, duke iu përgjigjur kërkesave të

mëposhtme:

a) Lejohen adaptimet dhe ndërtimet shtesë në dhe pranë ndërtimeve ekzistuese, por pa cenuar karakteristikat e përgjithshme të qytetit-muze (përmasat, volumet, materialet, formën e mbulesës së ndërtimit, ngjyrat etj.).

b) Ndërtimet e reja duhet të respektojnë karakterin e ndërtimeve të qytetit-muze (volumet, mbulesën, ngjyrat etj.).

Neni 6

Ndërhyrjet në monumentet e kulturës

Në ndërtimet ekzistuese, të cilat ndodhen në qendrën historike dhe nuk përputhen me karakterin e qyteti-muze, mund të kryhen ndërhyrje adaptuese në volume apo trajtimin e jashtëm të tyre, me synimin e bashkëpërfshirjes në karakterin urbanistiko-arkitektonik të qytetit, në përputhje me ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore".

Neni 7

Kategoritë e monumenteve të kulturës

Monumentet e qytetit-muze, në bazë të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", grupohen sipas vlerës në dy kategori: monumente të kategorisë I dhe monumente të kategorisë II.

Grupimi i monumenteve në kategori synon diferencimin sipas vlerave të tyre, duke u lidhur kjo edhe me metodat e ndërhyrjeve të konservimit, restaurimit dhe adaptimit të tyre për përdorim.

Neni 8

Monumentet e kategorisë I

Monumentet e kategorisë I janë shembujt me vlera të rëndësishme për sa i përket gjinisë dhe tipit si hallka në evolucionin shekullor të tyre në qytetin-muze. Këto monumente ruhen në qendrën historike, zonën e lirë dhe jashtë tyre. Oborri, ndërtimet ndihmëse dhe muret rrethuese janë pjesë e monumentit. Monument i kategorisë I mund të jetë edhe një pjesë e ndërtimit.

Në monumentet e kategorisë së parë nuk lejohet asnjë lloj ndërhyrje, e cila mund të prekë kompozimin, trajtimin arkitektonik të jashtëm, si dhe zgjidhjet planimetriko-funksionale.

Monumentet e kategorisë I mund të përdoren si për funksionet për të cilat janë ndërtuar, ashtu edhe për funksione të tjera, me kusht që të mos cenohen vlerat për të cilat mbrohet. Në raste të veçanta, lejohen adaptime me materiale të lehta, pa cenuar vlerat autentike.

Neni 9

Monumentet e kategorisë II

Monumente të kategorisë II janë të gjitha ndërtimet, duke përjashtuar monumentet e kategorisë së parë, të cilat përfshihen në brendësi të qendrës historike (zonë-muze dhe zonë e mbrojtur).

Në monumentet e kategorisë së dytë lejohen ndryshime dhe adaptime të brendshme për një shfrytëzim më racional dhe më komod, duke përdorur edhe materiale dhe struktura të kohës, me kusht që të mos cenohet pamja e jashtme e monumentit. Në raste të veçanta dhe të rralla, mund të lejohen edhe ndryshime të vogla të pamjes së jashtme në pamje sekondare, sipas studimeve të Institutit të Monumenteve të Kulturës.

Në brendësi të monumenteve të kategorisë së dytë dhe kryesisht në banesa ruhen mjediset karakteristike, dekori dhe mobilimi arkitektonik me vlerë.

Neni 10
Restaurimet e monumenteve të kategorisë I dhe II

Studimi dhe projektet e hartuara për restaurimin e monumenteve të kategorisë I dhe II paraqiten nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Monumenteve të Kulturës, Gjirokastër, si dhe persona fizikë ose juridikë të licencuar për këtë qëllim dhe miratohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

Neni 11
Restaurimet në qendrën historike dhe zonën e lirë

Punimet e konservimit dhe restaurimit, të miratuara në të gjitha monumentet duke përfshirë këtu muret rrethuese, portat e jashtme, rrugët etj., kryhen prej Institutit të Monumenteve të Kulturës ose personat fizikë ose juridikë të licencuar për këtë qëllim.

Neni 12
Ndërtimet e reja në qytetin-muze

Për zhvillimin e mëtejshëm të qytetit, plani i përgjithshëm urbanistik duhet të respektojë zonifikimin e qytetit-muze dhe rregulloren përkatëse. Në këto raste, vendimet e Këshillit të Rregullimit të Territorit të Bashkisë Gjirokastër duhet të jenë në përputhje me nenin 38 të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”.

Neni 13
Komiteti Mbikëqyrës i qytetit-muze

Pranë bashkisë së qytetit Gjirokastër atashohet Komiteti Mbikëqyrës i qytetit-muze, një strukturë këshillimore, jofunksionare, me përfaqësues të njësisë së pushtetit vendor dhe me përfaqësues, specialistë nga Drejtoria Rajonale e Monumenteve të Kulturës të Gjirokastrës, si dhe institucione të tjera të specializuara. Ky Komitet këshillon dhe u rekomandon strukturave përgjegjëse të qeverisjes vendore masa për përmirësimin dhe arritjen e standardeve kombëtare për miradministrimin, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të qytetit-muze të Gjirokastrës.

Komiteti përbëhet nga 7 anëtarë. Kryetar i Komitetit Mbikëqyrës caktohet Kryetari i Bashkisë së qytetit Gjirokastër.

Rregullorja e funksionimit të Komitetit Mbikëqyrës dhe emrat e anëtarëve propozohen nga vetë subjektet përfaqësuese në Komitet dhe miratohen me vendim të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastër.

Neni 14
Format e bashkëpunimit

Komiteti Mbikëqyrës i qytetit-muze bashkëpunon me organet e pushtetit vendor dhe atë qendror, në bazë të marrëveshjeve të përbashkëta midis tyre.

Neni 15
Dispozita të fundit

Shtesat dhe ndryshimet në këtë rregullore bëhen me propozim të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Kjo rregullore bashkëshoqërohet me hartën e zonifikimit të qytetit-muze të Gjirokastrës.

VENDIM
Nr.840, datë 20.12. 2003

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË OFERTUESVE DHE SHPALLJEN E FITUESIT, NË TENDERIN E HAPUR NDËRKOMBËTAR, PËR PRIVATIZIMIN E BANKËS SË KURSIMEVE SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8563, datë 22.12.1999 "Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të Bankës së Kursimeve sh.a.", i ndryshuar dhe të vendimit nr.452, datë 28.6.2001 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e procedurave të privatizimit dhe të termave të kontratës së shitjes së aksioneve të Bankës së Kursimeve sh.a.", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së ofertuesve, sipas raportit të Komisionit të vlerësimit të ofertave, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Miratimin e Raiffeisen Zentralbank Ősterreich AG, fituese për blerjen e aksioneve të Bankës së Kursimeve sh.a., në masën 100 për qind, me vlerë 126 000 000 (njëqind e njëzet e gjashtë milionë) USD, me çmim për çdo aksion 18 000 (tetëmbëdhjetë mijë) USD.
3. Forma dhe mënyra e pagesës të jetë në *cash*.
4. Ngarkohet Ministri i Financave për nënshkrimin e kontratës përfundimtare me fituesin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

RAPORTI I KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË OFERTAVE TË TENDERIT
PRIVATIZIMI I BANKËS SË KURSIMEVE SHA

a) Objekti i ofertës dhe numri i aksioneve të vëna në shitje

Mbështetur në ligjin nr.8563, datë 22.12.1999 "Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të Bankës së Kursimeve sh.a.", i ndryshuar, si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.452, datë 28.6.2001, i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.630, datë 18.9.2003, Banka e Kursimeve sh.a. iu nënshtrua procedurave të privatizimit.

Bazuar në formulën e privatizimit, të përcaktuar në ligjin e sipërpërmendur për privatizimin e Bankës së Kursimeve sh.a., u zbatua procedura e tenderit të hapur ndërkombëtar, duke vënë në shitje jo më pak se 35 për qind të aksioneve.

Për këtë qëllim, Ministria e Financave gjatë gjithë vitit 2003 ka punuar mbi bazën e një plani veprimesh, në të cilin u përcaktuan të gjitha hapat që do të ndërmerreshin në funksion të privatizimit.

Në përputhje me procedurat e tenderimit të Bankës Botërore dhe të financuara prej saj, u përzgjodhën këshilltari i privatizimit dhe këshilltari ligjor, të cilët asistuan gjithë procesin.

Gjithashtu, gjatë vitit 2003 u realizua auditimi i bilancit të vitit 2002 dhe të 6-mujorit të parë të vitit 2003 të Bankës së Kursimeve sh.a. nga shoqëria audituese "Deloitte & Touche".

Përveç auditimit u krye dhe vlerësimi i Bankës së Kursimeve (një kopje të të cilit e gjeni bashkëlidhur) nga shoqëria KPMG.

Gjithashtu, gjatë vitit 2003 Banka e Kursimeve vazhdoi t'i nënshtrohej ristrukturimit, për ta bërë Bankën sa më tërheqëse për investitorët strategjikë.

Gjatë muajit qershor 2003, Ministria e Financave filloi procesin e marketingut, i cili konsistoi në kontakte me disa banka të interesuara për blerjen e aksioneve të saj. Ky proces vazhdoi edhe gjatë muajit shtator 2003, madje në mënyrë më intensive e duke u përqëndruar kryesisht tek bankat që shprehnin interes më të madh.

Në muajin shtator Ministria e Financave publikoi ftesën për tender në gazetën ndërkombëtare "Financial Times", si dhe në disa gazeta lokale.

Bazuar në planin e veprimeve, bankat që shprehin interes ishin OTP (Hungari) dhe Raiffeisen (Austri), të cilat iu nënshtruan procedurave të tenderit për parakualifikim. Komisioni i vlerësimit të ofertave, bazuar në procedurat e tenderit, në fazën e parakualifikimit (Aneksi 1), vendosi t'i parakualifikojë të dyja bankat dhe njëkohësisht t'ua dërgojë atyre vendimin e parakualifikimit, si dhe ftesën për të kryer Due-Diligence. Gjatë muajit nëntor 2003 ato e kryen të dyja këtë proces.

Më pas, me asistencën e këshilltarit ligjor ndërkombëtar, u hartua kontrata e shitjes së aksioneve të Bankës së Kursimeve, e cila, në përputhje me procedurat e përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për disa ditë me radhë u negociua me të dyja bankat dhe pas këtyre negociatave u dërgua për miratim versioni përfundimtar i kontratës në Këshillin e Ministrave, që me vendimin nr.823 të datës 11.12.2003 bëri miratimin e saj. Kjo kontratë, në formën e miratuar nga Këshilli i Ministrave, ishte një ndër dokumentet e ofertës, e cila duhej të paraqitej e nënshkruar, pa ndryshime, nga secili ofertues. (Kjo gjë iu bë e ditur të dy ofertuesve përmes një letre të Ministrit të Financave, që i bashkëlidhet këtij raporti.)

b) Përmbledhje e procedurës dhe numri i ofertave të paraqitura

Më datë 17.12.2003, në orën 9:30, sipas ftesës për tender, Komisioni i vlerësimit të ofertave e deklaroi të hapur tenderin për privatizimin e Bankës së Kursimeve, në prani të mediave.

Të dy ofertuesit filluan të dorëzonin dokumentacionin e kërkuar në "Ftesën për tender". OTP-ja dorëzoi zarfin me dokumentacionin e "Plotësimit të kushteve paraprake", një zarf me "Ofertën financiare" dhe zarfin me "Ofertën teknike". Ofertuesi Raiffeisen dorëzoi zarfin me dokumentet për "Plotësimin e kushteve paraprake" dhe kërkoi që zarfin me "Ofertën financiare" dhe atë të "Ofertës teknike" t'i dorëzonte në orën 12:30, pasi Komisioni të kishte shqyrtuar dokumentet e zarfit me dokumentet për "Plotësimin e kushteve paraprake", pasi mendonin se nuk duhej të procedohej më tej, në rast se banka Raiffeisen nuk i plotësonte kushtet paraprake. Pas refuzimit të kësaj kërkese nga ana e Komisionit, Raiffeisen pranoi të dorëzonte edhe zarfin me "Ofertën financiare" dhe atë të "Ofertës teknike".

Më pas, Komisioni vazhdoi procedurën për verifikimin dhe kontrollin e dokumenteve të paraqitura nga ofertuesit. Nga verifikimi dhe kontrolli formal i tyre rezultoi se bankat pjesëmarrëse i kishin paraqitur të gjitha dokumentet e kërkuara nga procedurat e tenderit, pra (1) dokumentacionin për përmbushjen e kushteve paraprake (2) ofertën financiare dhe (3) ofertën teknike. Komisioni vendosi që ofertat të hapeshin me radhë sipas rendit alfabetik, pra duke filluar me ofertuesin OTP dhe më pas duke vazhduar me ofertën e ofertuesit Raiffeisen Bank. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të zarfit me kushtet paraprake të ofertuesit OTP, Komisioni konstatoi se ndryshimet në kontratë fillonin nga faqja 5 e kontratës së shitjes së aksioneve, konkretisht paragrafi 2 dhe 3. Kërkesat e procedurave të tenderit kërkojnë që kontrata duhej të paraqitej e nënshkruar nga ofertuesi OTP, e pandryshuar, sipas variantit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.823 të datës 11 dhjetor 2003. Të njëjtën shkelje Komisioni konstatoi edhe në kontratën e shitjes së nënshkruar nga ofertuesi Raiffeisen, që kishte bërë ndryshim duke filluar nga faqja 11, paragrafi 7.1.17.10 të saj. Në këto kushte Komisioni gjykoi se nuk duheshin vazhduar procedurat për hapjen e ofertës teknike dhe të asaj financiare të asnjërit ofertues. Gjithashtu, Komisioni gjykoi të udhës të thërriste përfaqësuesit e të dy ofertuesve dhe, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 452, datë 28.6.2001, që të jepnin informacion shtesë, pra të paraqitnin kontratën e nënshkruar sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ofertuesit e pranuan këtë sugjerim dhe kërkuan kohë për të siguruar dhe paraqitur kontratën e mësipërme, dhe konkretisht u caktua ora 18:45.

Ofertuesi Raiffeisen dorëzoi menjëherë kontratën e nënshkruar pa ndryshime, ndërsa ofertuesi OTP kërkoi fillimisht një orë kohë për ta paraqitur kontratën, pastaj njoftoi se i duhej një kohë më e gjatë dhe kërkoi orën 19:45, por edhe këtë herë nuk u paraqit në orën e ricaktuar, por në ora 20:30 dhe i dorëzoi Komisionit një letër në të cilën deklaronte mospranimin për të paraqitur kontratën e nënshkruar pa ndryshime, edhe pse është kusht i domosdoshëm për respektimin e procedurave të tenderit. Ofertuesi OTP kërkoi vazhdimin e procedurave me kontratën e nënshkruar, me ndryshime, të dorëzuar në orën 9:30. Duke mos gjetur zgjidhje tjetër, të lejueshme nga legjislacioni i privatizimit dhe procedurat e tenderit, Komisioni vendosi të vazhdojë procedurën e tenderit, duke marrë vendim për të hapur ofertën financiare të bankës Raiffeisen, si ofertues që përmbushte kushtet paraprake.

Më pas, kryetari i Komisionit, në prani të përfaqësuesve të të dy ofertuesve dhe të medias,

konform procedurave ligjore, hapi ofertën financiare të ofertuesit Raiffeisen dhe e lexoi atë me zë. Oferta financiare e paraqitur shpallte çmimin total të blerjes së 7000 aksioneve, përkundrejt çmimit për aksion 18 000 USD, baras me 126 milionë USD.

Më datë 19 dhjetor 2003, OTP-ja dorëzoi një letër në protokollin e Ministrisë së Financave me nr.8626/4 në të cilën pranohet ndryshimi i kontratës vetëm në disa terma teknike. Kjo letër bie në kundërshtim me letrën po të OTP-së të datës 17 dhjetor me nr.8626/3 prot. në të cilën nuk pranohet nga OTP-ja të paraqesin kontratën finale të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Komisioni vlerësoi se pranimi i kontratës nga ana e komisionit, me çfarëdolloj ndryshimi, do të çonte në diskriminimin e ofertuesve në tender.

c) Përmbledhje e ofertave të paraqitura

Nga shqyrtimi i procedurave të tenderit rezultoi se OTP-ja ka paraqitur një ndër dokumentet e kërkuara në shkelje të kërkesave të përcaktuara në ftesën për tender, pavarësisht sqarimeve të bëra gjatë procesit të negocimit të kushteve të projektkontratës me të dy ofertuesit, si dhe të letrës së dërguar nga këshilltari i privatizimit, si dhe të letrës së dërguar nga Ministri i Financave më datë 16 dhjetor 2003. Më konkretisht, banka OTP paraqiti kontratën e shitjes së aksioneve, të nënshkruar me ndryshime (materiali bashkëlidhur), gjë që Komisioni e vlerësoi si shkelje thelbësore të kushteve të tenderit dhe të deklaratës së përfaqësuesve të ofertuesit OTP për njohjen dhe zbatimin e kushteve të tenderit. Për rrjedhojë, Komisioni u detyrua të vazhdonte procedurën duke bërë vlerësimin e ofertave financiare e teknike të ofertuesit Raiffeisen Bank.

d) Kriteri kryesor i vlerësimit të ofertës

Komisioni vazhdoi me procedurat e vlerësimit, duke i dhënë ofertuesit Raiffeisen Bank:

a) 75 pikë për ofertën financiare,
b) 5 pikë për planin e biznesit,
c) 13. 22 pikë për fortësinë dhe eksperiencën financiare.

e) Përmbledhje e rezultateve të procedurave të tenderit, së bashku me listën e ofertuesve që rezulton nga vlerësimi i ofertave:

Ofertuesi fitues Raiffeisen Bank
Oferta financiare 126 milionë dollarë amerikanë në *cash.*

VENDIM
Nr.848, datë 19.12.2003

PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE TË STRUKTURËS SË FORMULËS SË PRIVATIZIMIT TË SHOQËRISË "UZINA MEKANIKE E NAFTËS" SHPK, KUÇOVË DHE KRITERET BAZË PËR PËRZGJEDHJEN E INVESTITORIT E PËR VLERËSIMIN E OFERTAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2 dhe 3 të ligjit nr.9073, datë 29.5.2003 "Për privatizimin e shoqërisë "Uzina Mekanike e Naftës" sh.p.k., Kuçovë" dhe të nenit 3 të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998 "Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për privatizimin e shoqërisë "Uzina Mekanike e Naftës" sh.p.k., Kuçovë. Forma e privatizimit të jetë ajo e transferimit te të tretët e të drejtës së pronësisë të kuotave të kapitalit të saj.

2. Struktura e formulës së privatizimit të kuotave të kapitalit të shoqërisë të jetë:

a) Jo më pak se 51 për qind e kuotave të kapitalit i ofrohen për transferim investitorit, nëpërmjet shitjes me tender të hapur. Pagesa e kësaj pakete kuotash të kapitalit të bëhet me para.

b) Ish-pronarëve të truallit u ofrohen kuotat e kapitalit, sipas vlerës së truallit të përfshirë në kapitalin e shoqërisë, siç përcaktohet në vendimin nr.169, datë 13.3.2003 të Këshillit të Ministrave dhe sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

c) Punonjësve të shoqërisë u ofrohen, proporcionalisht, kuotat e kapitalit të shoqërisë, në

shkëmbim dhe në raport me vlerën e bonove të privatizimit, që u janë dhënë atyre nga shteti. Punonjës të uzinës mekanike të naftës sh.p.k, Kuçovë janë punonjësit, të cilët kanë qenë në marrëdhenie pune që nga krijimi i shoqërisë deri në çastin e hyrjes në fuqi të ligjit nr.9073, datë 29.5.2003, si dhe ata që kanë dalë në asistencë, me vendimin nr.422, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave.

3. Procedurat e tenderit të jenë sipas vendimit nr.529, datë 21.8.1998 të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e tenderimit të paketave të aksioneve, që zotërohen nga shteti, të shoqërive tregtare", me ndryshimet përkatëse.

4. Përzgjedhja e investitorit të bëhet sipas kritereve të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Vlerësimi i ofertave të investitorëve, që plotësojnë kriteret sipas shtojcës 1, të bëhet në mbështetje të kritereve të mëposhtme:

a) Çmimi i ofruar 85 pikë.
b) Vlerat e investimit 10 pikë.
c) Plani i biznesit dhe cilësia e tij 5 pikë.

6. Punonjësit, që dalin të papunë nga procesi i privatizimit, të paguhen për 2 vjet me pagën bazë që kanë pasur në çastin e largimit nga puna. Efektet financiare të përballohen nga Buxheti i Shtetit, pas transferimit të fondit financiar të të ardhurave nga privatizimi. Caktimi, administrimi dhe pagesa të bëhet nga zyrat përkatëse të punësimit.

7. Periudha 2-vjeçare t'u njihet punonjësve periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni pleqërie, invaliditeti dhe familjar, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, kundrejt pagesës së kontributit në fondin e sigurimit shoqëror të detyrueshëm, nga Buxheti i Shtetit. Periudha e mësipërme shënohet në librezën e punës.

8. Të drejtën e përfitimit të pagesës sipas këtij vendimi e kanë ata punonjës, të cilët nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike si punëdhënës, punëmarrës apo të vetëpunësuar, me përjashtim të të vetëpunësuarve në bujqësi. Në rast të kundërt, u ndërpritet pagesa që përfitojnë sipas këtij vendimi.

9. Kontributet e papaguara, së bashku me kamatëvonesat, që uzina mekanike e naftës, sh.p.k., Kuçovë ka ndaj sigurimeve shoqërore, të shlyhet brenda 30 ditëve nga arkëtimet, që do të realizohen nga privatizimi i shoqërisë.

10. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË INVESTITORIT STRATEGJIKË TË INTERESUAR PËR BLERJEN E PAKETËS SË KUOTAVE TË KAPITALIT TË SHOQËRISË "UZINA MEKANIKE E NAFTËS" SHPK, KUÇOVË

SHTOJCA 1

I. Midis investitorëve që do të kenë dërguar shrehjen e interesit, duke përmbushur kërkesat e treguara në njoftimin publik, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.529, datë 21.8.1998 "Për procedurat e tenderimit të paketave të aksioneve që zotërohen nga shteti të shoqërive tregtare", si dhe të përmbushin kërkesat e parashikuara në pikën II, sipas afateve të parashikuara në të.

II. Investitorët e interesuar, që do të ftohen të paraqesin ofertat e tyre të detyrueshme, duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme paraprake:

a) Të jenë persona juridikë.

b) Të kenë një kapital, tërësisht të paguar, jo më pak se 3 milionë USD apo ekuivalentin e shumës, në valutën në të cilën është shprehur kapitali; vlera neto dhe sipas rastit, vlera neto e konsoliduar, duhet të jetë jo më pak se tre vjetët e fundit.

c) Të jenë shoqëri e specializuar në industrinë mekanike, ose konsorcium ku kontrollin e shoqërisë ta ketë shoqëria e specializuar në industrinë mekanike, e cila të ketë një aktivitet në industrinë mekanike jo më pak se tre vitet e fundit.

Të gjitha këto kërkesa do të vërtetohen nëpërmjet certifikatave zyrtare, të lëshuara nga autoritetet përkatëse ose me anë të dokumenteve të tjera, të shkruara zyrtare.

Palët, të cilat janë në likuidim ose nuk kanë aftësi paguese ose procedime të tjera të ngjashme ose ndonjë procedim që nënkupton një mosaftësi paguese ose ndërprerje të biznesit, nuk do të pranohen.

VENDIM
Nr.849, datë 19.12.2003

PËR FUNKSIONIMIN E FOTOTEKËS KOMBËTARE "MARUBI" DHE PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT NGA BASHKIA E SHKODRËS MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "c" të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1. 2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" dhe të pikës 3 të nenit 53 të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fototeka Kombëtare "Marubi" është person juridik, publik, në varësi të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Godina e Fototekës Kombëtare "Marubi" dhe inventari i mjeteve kryesore t'i kalojnë në përgjegjësi administrimi nga Bashkia e Shkodrës Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Fondi për shpenzimet e pagave për punonjësit e Fototekës, të cilët do të përfshihen brenda numrit të përgjithshmëm të punonjësve buxhetorë të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, dhe shpenzimet e tjera të përballohen nga buxheti i vitit 2004 i kësaj ministrie.

4. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të miratojë statutin e Fototekës Kombëtare "Marubi".

5. Ngarkohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Bashkia e Shkodrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shkrin efektet nga data 1 janar 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.857, datë 19.12.2003

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT TË ZYRËS SË ADMINISTRIMIT DHE KOORDINIMIT TË PARKUT KOMBËTAR TË BUTRINTIT

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 29 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullores së funksionimit të Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar të Butrintit, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

RREGULLORE
E FUNKSIONIMIT TË ZYRËS SË ADMINISTRIMIT DHE KOORDINIMIT TË PARKUT KOMBËTAR BUTRINT

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Pika 1

Kjo rregullore hartohet bazuar në:

a) Ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore"

b) Ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura"

c) Ligjin nr.8934, datë 5.9.2002 " Për mbrojtjen e mjedisit"

d) Ligjin nr.7908, datë 5.4.1995, ndryshuar me ligjin nr.8763, datë 2.4.2001, ndryshuar me ligjin nr.8870, datë 21.30.2002 "Për peshkimin dhe akuakulturën"

e) Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.450, datë 1.7.1998 i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.176, datë 3.5.2002 "Për administrimin e qytetit antik të Butrintit"

f) Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.82, datë 2.3.2000 "Për shpalljen park kombëtar në mbrojtje të shtetit të zonës arkeologjike të Butrintit"

g) Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.266, datë 24.4.2003 "Për administratën e zonave të mbrojtura"

h) Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.531, datë 31.10.2002 " Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit dhe të territorit përreth tij zonë natyrore, veçanërisht e mbrojtur dhe përfshirjen e tij në listën e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë"

Pika 2

Në këtë rregullore ZAKB do të thotë Zyra e Administrimit dhe e Koordinimit Butrint. PKB do të thotë Parku Kombëtar Butrint.

Pika 3

Me vendim të Këshillit të Ministrave nr.82, datë 2.3.2000, shpallet park kombëtar në mbrojtje të shtetit zona arkeologjike e Butrintit dhe për administrimin e këtij parku kombëtar ngarkohet Zyra e Administrimit dhe Koordinimit, njësi nën juridiksionin e MKRS-së.

Pika 4

Për aktet normative që do të zbatohen nga ZAKB-ja ushtron veprimtarinë e tij Bordi i Butrintit, i cili shqyrton dhe miraton strategjinë dhe politikat për zhvillimin, mirëmbajtjen,

koordinimin, menaxhimin dhe promovimin e vlerave të Parkut Kombëtar të Butrintit. Për zbatimin e veprimtarisë së tij, Bordi mbështetet në rregulloren e tij të miratuar nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

ZAKB-ja, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve dhe të Kullotave dhe Drejtorinë e Peshkimit, realizon planin e menaxhimit të zonës, në përputhje me ligjin nr.8960, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura".

Pika 5

ZAKB-ja është person juridik publik që nuk ndjek qëllime ekonomike. Ai e ka selinë në Sarandë me adresë "Ish-Muzeu Etnografik".

ZAKB-ja ka vulën dhe logon e saj, pamja dhe elementet e së cilës janë sipas shtojcës nr.1, pjesë e kësaj rregulloreje.

Pika 6

ZAKB-ja mbështet, nxit, koordinon dhe mbikëqyr kërkimet shkencore, në bashkëpunim me institucione shtetërore ose private, kombëtare dhe ndërkombëtare për promovimin, ruajtjen, pasurimin dhe ekspozimin e trashëgimisë kulturore, për menaxhimin dhe ruajtjen e mjedisit në Parkun Kombëtar të Butrintit. ZAKB-ja publikon informacion për vlerat e Parkut Kombëtar të Butrintit, duke përdorur botime shkencore, guida, kartolina, periodikë dhe materiale të tjera publicitare.

KAPITULLI II
SHTRIRJA GJEOGRAFIKE E PARKUT, PËRCAKTIMI I ZONËS SË ADMINISTRUAR NGA ZAKB-JA

Pika 7

Parku Kombëtar i Butrinti është shpallur zonë e veçantë, e mbrojtur për trashëgiminë kulturore dhe vlerat e ekosistemit.

Ai mbulon një sipërfaqe prej 25 kilometra katrorë.

Zona përfshin sipërfaqe tokësore dhe ujore, në të cilat ekzistojnë tipare fiziko-gjeografike, specie të florës dhe të faunës, të rëndësisë biogjeografike, ekologjike, ekonomike, hidrologjike, estetike, si edhe qendra të trashëgimisë kulturore, monumente, muze, objekte, të gjitha këto me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kufijtë e zonës së administruar janë:

a) në veri, fshati Ksamil;

b) në lindje, rruga ekzistuese në drejtim të Konispolit;

c) në jug, lumi Pavlo, duke anashkaluar Vrinën, drejt fushës dhe duke u futur brenda zonës tek liqeni i Bufit;

d) në perëndim me gjirin e Butrintit, aty ku kanali i Vivarit derdhet në det.

Zonë e administruar nga ZAKB-ja do të thotë territori i përcaktuar në hartën në shtojcën 2, pjesë e kësaj rregulloreje.

KAPITULLI III
STRUKTURA ORGANIZATIVE E ZAKB-SË

Pika 8

Struktura organizative e ZAKB-së është ajo e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.450, datë 1.7.1998 "Për administrimin e qytetit antik të Butrintit".

- Drejtori
- Specialisti i arkeologjisë
- Specialisti i monumenteve të kulturës
- Specialisti i mjedisit
- Specialisti i turizmit

Pika 9

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit

Drejton dhe koordinon punën administrative, menaxhuese dhe veprimtarinë ekonomike të ZAKB-së, si dhe përfaqëson institucionin në marrëdhënie me të tretët.

Mban kontakte dhe marrëdhënie me institucione shtetërore dhe private, me persona juridikë dhe fizikë, me organizma kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Koordinon dhe harton plane zhvillimi, të detajuara në përputhje me natyrën dhe masën e zhvillimit të përcaktuara nga plani i menaxhimit.

Drejton studimin e efekteve mjedisore të çdo ndërtimi ose zhvillimi të propozuar brenda territorit, mbështetur në ligjin nr.8990, datë 23.1.2003 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", rregullores së ZAK-së, Parku Kombëtar Butrint dhe planit të menaxhimit.

Vlerëson dhe përdor faktorë stimulues financiarë, si grantet, huatë, kontratat ose marrëveshjet e menaxhimit për të nxitur zhvillimin dhe menaxhimin me efektivitet të territorit të Parkut Kombëtar të Butrintit.

Bashkëpunon me drejtorinë e peshkimit për probleme të peshkimit në territorin e administruar, mbështetur në ligjin nr.7908, datë 5.4.1995, me ndryshimet përkatëse, në ligjin nr. 8870, datë 21.30.2002 "Për peshkimin dhe akuakulturën" dhe kriteret e përcaktuara në planin e menaxhimit.

Lidh marrëveshje menaxhimi, bazuar në ligjin nr.7908, datë 5.4.1995 me ndryshimet përkatëse, në ligjin nr.8870, datë 21.3.2002 "Për peshkimin dhe akuakulturën", me persona fizikë ose juridikë për të ushtruar peshkimin në territorin e Parkut Kombëtar të Butrintit.

Bashkëpunon me drejtorinë e peshkimit për të ndaluar ose kufizuar peshkimin sportiv sipas zonës, stinës dhe metodës së kapjes, mbështetur në ligjin nr.7908, datë 5.4.1995, në ligjin nr. 8870, datë 21.30.2002 "Për peshkimin dhe akuakulturën" dhe kritereve të planit të menaxhimit.

Ndalon gjuetinë në të gjithë territorin e Parkut Kombëtar të Butrintit, bazuar në nenin 6 të ligjit 8906, datë 6.6.2002 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis".

Përcakton numrin, vendin, llojin dhe veprimtaritë turistike në territorin e Parkut Kombëtar të Butrintit sipas planit të menaxhimit, duke koordinuar me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministrinë e Turizmit, mbi bazën e strategjisë së zhvillimit të turizmit ose planeve të zhvillimit turistik të rajonit të Sarandës.

Bazuar në ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", ndalon ndërtimin e ndërtesave në territorin e Parkut Kombëtar të Butrintit.

Aprovon restaurimin e ndërtesave ekzistuese në park, pas projektit të miratuar për këtë qëllim, për ruajtjen e karakterit të veçantë të territorit, për të parandaluar veprime që bien ndesh me qëllimin e krijimit të Parkut Kombëtar të Butrintit. Rikonstruksioni i godinave ekzistuese duhet të realizohet në përputhje me konceptin e planit të menaxhimit, duke respektuar traditën e zonës.

Miraton vendqendrime të përshtatshme, sipas kritereve të planit të menaxhimit për automjetet që hyjnë në territorin e Parkut Kombëtar të Butrintit.

Mban lidhje të vazhdueshme dhe informon strukturat e pushtetit qendror dhe vendor, për zhvillime të karaktereve të ndryshme që kryhen jashtë territorit të Parkut Kombëtar të Butrintit, por që mund të kenë impakte në park.

Pika 10

Detyrat dhe përgjegjësitë e arkeologut të ZAKB-së

Përpilon evidencat arkeologjike në territorin e Parkut Kombëtar të Butrintit për monitorimin dhe mbrojtjen e pasurive arkeologjike në territor.

Nuk lejon asnjë gërmim arkeologjik pa pasur miratimin e Bordit të Butrintit mbi projektin e paraqitur dhe që është në kundërshtim me ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore".

Nuk lejon gërmime arkeologjike pa praninë e specialistëve shqiptarë dhe përfaqësuesit e ZAKB-së.

Rregullon dhe organizon transportin e objekteve arkeologjike, duke penguar zhvendosjen ilegale të tyre.

Arkeologu në ZAKB është përgjegjës për hartimin e programit vjetor në bashkëpunim me Institutin e Arkeologjisë në bazë të objektivave dhe politikave të zhvillimit, të miratuara nga Bordi i Butrintit.

Ndjek punimet e mirëmbajtjes dhe punime të tjera në park, me qëllim ruajtjen e vlerave arkeologjike.

Zbaton praktikat më të mira arkeologjike, duke përdorur teknikat dhe studimet akademike bashkëkohore.

Kryen kërkime arkeologjike sipas planit shkencor njëvjeçar, të miratuar nga Bordi i Butrintit.

Ndihmon në hartimin e programit edukativ, duke synuar shndërrimin e parkut në një qendër kulturore, edukimi.

Organizon programe për studentë për qëllime arkeologjike.

Siguron marrjen e masave që objektet arkeologjike të zbuluara të ekspozohen ose të mbulohen për ruajtje sipas metodave bashkëkohore.

Përpilon materiale për arkivin në lidhje me zbulimet arkeologjike.

Përfaqëson ZAKB-në në ekspeditat e përbashkëta arkeologjike në territorin e parkut.

Parashikon, në bashkëpunim me specialistin e Institutit të Monumenteve të Kulturës, fondet që duhen për ruajtjen e rrënojave që dalin gjatë gërmimeve arkeologjike.

Punon për njohjen në tërësi të vlerave arkeologjike të parkut në mediat e shkruara dhe elektronike.

Pika 11

Detyrat dhe përgjegjësitë e specialistit të monumenteve

Specialisti i monumenteve në ZAKB është përgjegjës për hartimin e programit vjetor në park, në bashkëpunim me Institutin e Monumenteve të Kulturës, sipas politikave dhe objektivave të zhvillimit, të miratuara nga Bordi i Butrintit.

Zbaton një program vjetor të hartuar në bashkëpunim me Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe të miratuar në Bordin e Butrintit.

Dokumenton monumentet përpara fillimit të çdo procesi restaurimi.

Respekton rregullat e restaurimit të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

Harton një program vjetor që synon ruajtjen e monumenteve në gjendjen ekzistuese, si dhe hapat që duhen marrë për të parandaluar dëmtimet.

Vrojton kushtet fizike të monumenteve dhe i raporton drejtorit të ZAKB-së dhe Institutit të Monumenteve të Kulturës.

Përfaqëson ZAKB-në në projektet restauruese në territorin e parkut dhe merr pjesë në ekspeditat arkeologjike në këtë territor.

Monitoron gërmimet e kryera rreth monumenteve, duke informuar ZAKB-në mbi ecurinë dhe gjendjen e gërmimeve dhe impaktin e tyre në monumente.

Ndalon gërmimet dhe restaurimet në monumente, kur këto gërmime dhe restaurime dëmtojnë strukturën e monumenteve dhe bien ndesh me ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”.

Ndalon gërmimet dhe restaurimet në territorin e Parkut Kombëtar të Butrintit, kur këto dëmtojnë mjedisin.

Menaxhon dhe kontribuon në rritjen cilësore të Muzeut të Butrintit, duke e kthyer atë në një qendër të rëndësishme edukimi në park.

Pika 12

Detyrat dhe përgjegjësitë e specialistit të mjedisit

Monitoron dhe merr masat e nevojshme për mbrojtjen dhe ruajtjen e karakterit funksional të territorit.

Bën sugjerime për zgjerimin e zonës së mbrojtur të administruar nga zyra.

Monitoron habitatet, duke përdorur të gjitha mënyrat, sipas sezonit dhe në çdo kohë.

Merr masa mbrojtëse kundër zjarrit, sipas nevojave dhe zonave të përcaktuara në hartë.

Ndihmon dhe bashkëpunon me organizatat joqeveritare, që punojnë për ruajtjen e territorit dhe

burimeve të tij natyrore.

Ndërhyn për të ndaluar dëmtimet që mund të shkaktohen në mjedisin e Parkut Kombëtar të Butrintit.

Nis dhe zbaton projekte që përmirësojnë kushtet mjedisore dhe habitatet në territorin e Parkut Kombëtar të Butrintit.

Specialisti i mjedisit është përgjegjës për hartimin e programit vjetor në park, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, sipas objektivave dhe politikave të miratuara nga Bordi i Butrintit.

Kontrollon zbatimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e mjedisit në park.

Merr pjesë në përgatitjen e projekteve dhe veprimtarive në fushën e mjedisit dhe ndjek zbatimin e tyre.

Informon drejtorin e ZAKB-së, Bordin e Butrintit dhe Ministrinë e Mjedisit mbi shkeljet e ligjit dhe parregullsitë në territorin e parkut.

Identifikon masat që duhen të merren për miradministrimin e burimeve natyrore, florës, faunës, pyjeve dhe specieve të rrezikuara.

Bashkëpunon me inspektorët e mjedisit të Agjencisë Rajonale të Mjedisit në Sarandë për mbrojtjen e mjedisit në Parkun Kombëtar.

Bashkëpunon me strukturat e pushtetit vendor për miradministrimin e pyjeve dhe peshkimin.

Informon drejtorin e ZAKB-së mbi impaktet që kanë në mjedis projektet e propozuara për zbatim në park.

Bashkëpunon me organet e pushtetit qendror, si edhe me organe të pushtetit vendor për instalimin e sistemeve të ujrave të zeza apo hedhjes së mbeturinave për fshatrat brenda territorit ose në kufi me të.

Vlerëson gjendjen e resurseve natyrore në territor, nivelin për përdorimin e tyre maksimal, si edhe mundësinë e ripërtëritjes së ekosistemit, bazuar në ligjin nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, si edhe ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”.

Vlerëson aktivitetet social–kulturore dhe ekonomike, të parashikuara për t’u zhvilluar brenda territorit, të cilat mund të kenë ndikim në mjedis dhe informon drejtorin e zyrës.

Pika 13

Detyrat dhe përgjegjësitë e specialistit të turizmit

Specialisti i turizmit është përgjegjës për hartimin e programit vjetor në park, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, sipas objektivave dhe politikave të miratuara nga Bordi i Butrintit.

Detyrat dhe përgjegjësitë e tij janë:

- Kontrollon zbatimin e kuadrit ligjor për zhvillimin e turizmit në park.
- Merr pjesë në përgatitjen e projekteve dhe veprimtarive turistike dhe ndjek zbatimin e tyre.
- Harton informacione dhe statistika mbi numrin e vizitorëve në park dhe të dhëna të tjera të fushës dhe ia paraqet ato drejtorit të ZAKB-së.
- Propozon masat që duhet të merren për miradministrimin dhe mirëmenaxhimin e resurseve turistike të Parkut Kombëtar të Butrintit.
- Bashkëpunon me struktura të pushtetit vendor, me agjenci turistike, struktura hoteliere për rritjen e numrit të vizitorëve në park.

Pika 14

Përfaqësuesi i Bashkisë së Sarandës pranë kësaj zyre koordinon dhe mban lidhje ndërmjet ZAKB-së dhe pushtetit vendor Sarandë për probleme të ndryshme, që kanë të bëjnë me menaxhimin e veprimtarive në park.

KAPITULLI IV
ORGANIZIMI FINANCIAR

Pika 15

ZAKB-së është person juridik publik. Shpenzimet e ZAKB-së përballohen nga MKRS-ja dhe të ardhurat e PKB-së.

Institucionet përfaqësuese të Bordit të Butrintit kontribuojnë financiarisht për zbatimin e projekteve në park.

ZAKB–ja mund të marrë donacione dhe sponsorizime të ndryshme edhe nga institucione ose organizata të ligjshme, shtetërore ose joshtetërore, kombëtare ose ndërkombëtare.

Specialistët dhe punëtorët shtesë paguhen nga të ardhurat e ZAKB-së, sipas rregullave në fuqi.

Pika 16

ZAKB-ja paraqet për miratim në MKRS çdo 30 qershor, planin e veprimtarive dhe të investimeve për vitin e ardhshëm, të shoqëruar nga preventivat përkatëse dhe të miratuar më parë nga Bordi i Butrintit.

KAPITULLI V
RREGULLAT PËR ORGANIZIMIN E VEPRIMTARIVE KULTURORE–ARTISTIKE DHE VEPRIMTARITË E NDALUARA NË TERRITOR

Pika 17

Koncertet dhe veprimtaritë kulturore-artistike në territorin e Parkut Kombëtar të Butrintit bëhen me aprovimin e drejtorit të ZAKB-së dhe pas nënshkrimit të kontratës së rregullt midis dy palëve. Këto veprimtari kryhen bazuar në ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”.

Pika 18

Veprimtaritë e ndaluara në territorin e Parkut Kombëtar të Butrintit

Në territorin e parkut ndalohen:

Kryerja ose zhvillimi i aktiviteteve pa marrëveshje paraprake me drejtorin e ZAKB-së, si edhe në kundërshtim me ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore” apo me kushtet e vëna në lejen e lëshuar për këtë qëllim.

Gërmimi pa miratimin e Bordit të Butrintit dhe pa marrëveshje përkatëse me drejtorin e ZAKB-së.

Dëmtimi i objekteve arkeologjike ose monumenteve.

Mbledhja dhe transportimi i objekteve arkeologjike pa lejen e drejtorit të ZAKB-së.

Hyrja në ambientet me objekte arkeologjike ose muze jashtë orarit të caktuar, pa leje të veçantë nga drejtori i ZAKB-së.

Organizimi dhe ushtrimi i aktiviteteve ekonomike dhe sociale, në kundërshtim me ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, pa lejen mjedisore të Ministrisë së Mjedisit dhe lejen e Bordit të Butrintit, si dhe në rast të mospërmbushjes të kushteve shtesë ndaj lejes.

Dëmtimi i vegjetacionit natyral ose artificial nëpërmjet lëvizjes së pajisjeve, zjarrit, nxjerrje gurësh dhe aktivitete të tjera.

Prerja ose dëmtimi i pemëve, në kundërshim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Mbledhja, shqetësimi, shkatërrimi, dhe tregtimi i bimëve, kafshëve, jovertebrorëve ose organizmave ujore në kundërshtim me ligjin nr.8934, datë 5.9.2002 “ Për mbrojtjen e mjedisit”, si edhe ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”.

Ngacmimi dhe shkatërrimi i vezëve të zogjve, foleve ose zonave rreth foleve.

Peshkimi në territorin e Parkut Kombëtar të Butrintit, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe me rregullat shtesë, të miratuara për këtë qëllim.

Ushtrimi i skive në ujë ose skafeve të fuqishme në territorin ujor të Parkut Kombëtar të Butrintit.

Hedhja e pajisjeve, plehrave, materialeve inerte dhe mbeturinave, me përjashtim të vendeve të përcaktura për këtë qëllim.

Transportimi, hedhja, groposja ose trajtimi i mbetjeve të rrezikshme në territorin e Parkut Kombëtar të Butrintit, bazuar kjo në nenin 22 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

Ndotja e tokës ose e ujit brenda territorit nga aktivitete ekonomike ose të tjera, duke përfshirë

rrjedhje karburanti, vaji ose elemente të tjera nga mjetet lundruese.

Fotografimi ose filmimi për arsye komerciale, në kundërshtim me ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore".

KAPITULLI VI
RUAJTJA DHE SIGURIMI I TERRITORIT TË PARKUT KOMBËTAR TË BUTRINTIT

Pika 19

Drejtori i ZAKB-së lidh marrëveshje me persona fizikë ose juridikë për të siguruar informacion për vizitorët, për të mbikëqyrur territorin dhe për të siguruar zbatimin e masave mbrojtëse, të përcaktuara në pikën 20 të kësaj rregulloreje.

Pika 20
Detyrat dhe përgjegjësitë e rojeve të Parkut Kombëtar të Butrintit

Sigurojnë zbatimin e rregullave në territorin e Parkut Kombëtar të Butrintit dhe mbrojtjen e aseteve natyrale dhe kulturore.

Kërkojnë ndihmën e Policisë së Shtetit, shërbimit zjarrfikës dhe shërbimeve të tjera të emergjencës në kryerjen e detyrave të tyre.

Japin informacion dhe ndihmojnë vizitorët gjatë vizitës në territor.

Mbledhin informacion për gjendjen e monumenteve kulturore, arkeologjike dhe natyrore të parkut dhe ia raportojnë autoriteteve të Parkut Kombëtar të Butrintit.

Patrullojnë territorin për të zbuluar dhe për të neutralizuar çdo aktivitet që nuk është në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe rregulloret e miratuara për këtë qëllim, si edhe i raportojnë autoriteteve përkatëse kur çështja është jashtë kompetencës së tyre.

Vrojtojnë dhe i raportojnë drejtorin e ZAKB-së për aktivitetet ekonomike, social-kulturore dhe turistike që zhvillohen në territor.

Vrojtojnë dhe raportojnë drejtorin e ZAKB-së për çdo zhvillim brenda territorit.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

UDHËZIM
Nr.1, datë 10.12.2003

PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SHTETËRORE NË PËRDORIM TË ORGANIZATAVE TË MENAXHIMIT TË PESHKIMIT (OMP)

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.151, datë 13.3.2003 "Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të porteve të peshkimit në Vlorë dhe në Sarandë dhe për miratimin e marrëveshjes tip të kalimit në përdorim të porteve të peshkimit tek Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit (OMP)",

UDHËZOJMË:

1. Ndërmarrja e rritjes dhe zënies së midhjes dhe peshkut Sarandë u jep në përdorim (pa pagesë) Organizatave të Menaxhimit të Peshkimit (OMP) portet e peshkimit dhe infrastrukturat përkatëse sipas çdo urdhri nominal të Ministrit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit. Vlerësimi i objekteve në inventarin e dorëzimit të bëhet sipas rregullave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr.159, datë 13.3.2003 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, si dhe për procedurat e shitjes".

2. OMP-ja, gjatë përdorimit të kësaj pasurie shtetërore, të mos ndryshojnë qëllimin dhe destinacionin e përdorimit të saj.

Ndryshim destinacioni konsiderohet:

- përdorimi i ambienteve për qëllime jashtë objektit të veprimtarisë së OMP-së, parashikuar në nenet 6 dhe 7 të marrëveshjes tip;

- dhënia me qira e objekteve, shesheve dhe pasurisë tjetër shtetërore, subjekteve joanëtare të shoqatës.

Ndryshimi i qëllimit dhe i destinacionit të përdorimit të kësaj pasurie shtetërore i jep të drejtë ndërmarrjes së rritjes dhe zënies së midhjes dhe peshkut Sarandë që të prishë në mënyrë të njëanshme dhe të menjëhershme marrëveshjen tip me OMP-në përkatëse.

3. Në rastet kur OMP-ja disponon ambiente të tepërta, ato i vihen në dispozicion ndërmarrjes së rritjes dhe zënies së midhjes dhe peshkut Sarandë, e cila mund t'i përdorë vetë ose t'i japë me qira, konform dispozitave ligjore në fuqi.

4. Organizata e Menaxhimit të Peshkimit, sipas pikave 9 e 10 të marrëveshjes tip "Për transferimin në përdorim të portit të peshkimit …..", ka për detyrë të sigurojë ruajtjen e pasurisë shtetërore që i është dhënë në përdorim, si dhe rritjen e vlerës ekonomike të saj.

Ruajtje dhe rritje e vlerës ekonomike të kësaj pasurie shtetërore do të konsiderohet:

- sigurimi i detyrueshëm i pasurisë tek kompanitë e sigurimeve, me qëllim shmangien e rriskut nga dëmtimet;

- organizimi i ruajtjes së objekteve dhe pasurisë tjetër shtetërore nëpërmjet kompanive të specializuara të ruajtjes së pronave (policia private) ose me punonjësit e tyre;

- riparimet dhe mirëmbajtjet e zakonshme dhe të vazhdueshme të tyre.

- kryerja e investimeve për rritjen e kapaciteteve, mekanizimin, automatizimin dhe modernizimin e teknologjive nëpërmjet përdorimit me efektivitet:

a) të fondit të amortizimit, i cili llogaritet dhe përdoret nga OMP-ja;

b) të ardhurave nga aktiviteti i kësaj Organizate, sipas nenit 28 pika 2/b e statutit.

Për të gjitha këto investime, OMP–të duhet të marrin paraprakisht miratimin nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, nëpërmjet ndërmarrjes së rritjes dhe zënies së midhjes dhe peshkut, Sarandë.

5. Me dorëzimin e objekteve nga OMP-të, ndërmarrjes së rritjes dhe zënies së midhjes dhe peshkut, pas përfundimit të kontratës së përdorimit ose në raste të tjera kur janë objekt i saj, dhe kur këto objekte nuk do t'i jepen më OMP-së në përdorim të mëtejshëm, për investimet e kryera nga kjo e fundit, do të veprohet si më poshtë:

a) Vlera e investimeve për ndreqje themelore nuk llogaritet dhe nuk paguhet nga ndërmarrja e rritjes dhe zënies së midhjeve dhe peshkut.

b) Investimet që kanë të bëjnë me objekte të reja ose me rritjen e kapaciteteve të atyre ekzistuese dhe kur ato janë përfshirë në vlerën e këtyre objekteve, si shtesë kati, etj., i paguhen OMP-së nga ana e NRZMP-së, me vlerën e mbetur sipas kontabilitetit ose vlerësimit të bërë nga ekspertë të pavarur.

c) Për investimet e tjera të karakterit të objekteve të lëvizshme, si linja teknologjike, fabrika etj., dhe që nuk janë përfshirë në vlerën e objekteve ekzistuese, çmontohen nga ana e OMP-së, pa prishur anën funksionale të ndërtesës.

6. Drejtoria e Peshkimit, Drejtoria e Kontrollit Financiar pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe ndërmarrja e rritjes dhe zënies së midhjes dhe peshkut Sarandë, në zbatim të nenit 31/11 të ligjit nr.8870, datë 21.3.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7908, datë 5.4.1995 "Për peshkimin dhe akuakulturën" ngarkohen të kontrollojnë:

- dokumentacionin e transferimit të porteve të peshkimit nga ndërmarrja e rritjes dhe zënies së midhjes dhe peshkut Sarandë tek OMP-ja;

- mënyrën e përdorimit nga OMP-ja të kësaj pasurie shtetërore.

7. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen drejtoritë përkatëse pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, projekti pilot i zhvillimit të peshkimit, ndërmarrja e rritjes dhe zënies së midhjes dhe peshkut Sarandë dhe OMP–të.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit	Për Ministrinë e Ekonomisë
Agron DUKA	Arben MALAJ

URDHËR
Nr.17/5, datë 16.12.2003

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË ORGANIZATËS SË MENAXHIMIT TË PESHKIMIT (OMP BUTRINT)

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 dhe nenit 31/1 të ligjit nr.7908, datë 5.4.1995 "Për peshkimin dhe akuakulturën",

VENDOSA:

1. Miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP) Butrint, që i bashkëngjitet këtij urdhri.
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Agron Duka

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI TETOR 2003

1.	KUSHTETUTA	600
2.	PËRMBLEDHËSE NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
4.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
5.	KODI PENAL	400
6.	KODI I PUNËS	500
7.	KODI I FAMILJES	450
8.	KODI CIVIL	1000
9.	KODI RRUGOR	900
10.	KODI ZGJEDHOR	355
11.	PËRMBLEDHËSE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT DOGANOR	1500
13.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

Doli nga shtypi më 7.1.2004

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja Kristalina KH
Tiranë, 2004

Çmimi: 150 lekë